


Martesë në Gjykatë? Të drejtat e fëmijëve, martesa nën moshë dhe roli i gjykatës

Raport mbi aspektet ligjore, sociale dhe praktikën
gjyqësore të martesave nën moshë në Korçë dhe
Pogradec për periudhën 2011-2016



Ky raport hartohet në kuadrin e zbatimit të projektit *Parandalimi i martesave të hershme duke zbatuar mekanizmat ligjorë dhe perceptimin social, si një mjet për fuqizimin e grave dhe vajzave (PARANDALIM)*.

Projekti është zbatuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori), përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 2011- 2016 përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor (GjRrGj) Korçë e Pogradec. Fondi Kanadez për Nismat Lokale (CFLI) ka mbështetur financiarisht këtë projekt.

Autor:

Prof. Dr. Arta Mandro – Balili, - Analiza Ligjore e vendimeve të Gjyqësorit
Bernard Zeneli, MA - Analiza Sociale e martesave nën moshë

Supervizoi:

Elma Tërshana, MA

Menaxhoi:

Eridjona Kica, MA

© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky raport duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

 Blv. Bajram Curri
Pallatet Agimi, Shk.5, Ap. 81, Tiranë

 Tel: 00355 42 258 987

 Email: info@observator.org.al

 Webmail: www.observator.org.al

ISBN 978-9928-114-77-8

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe jo domosdoshmërisht paraqet opinionin e CFLI.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

i.	Lista e shkurtimeve	5
ii.	Lista e grafikëve	6
iii.	Lista e tabelave	7
iv.	Falënderime	8
v.	Përmbledhje ekzekutive	9
vi.	Çfarë është Observatori	11
vii.	Metodologjia	12
viii.	Dy fjalë për kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare lidhur me 'martesën nën moshë'	13

I - ANALIZA LIGJORE E VENDIMEVE TË GJYQËSORIT

1	Gjetje kryesore nga monitorimi i vendimeve gjyqësore të GjRrGj Korçë dhe Pogradec me objekt "lidhje martesë nën moshë" për periudhën 2011-2016	15
1.1	Të dhëna të përgjithshme lidhur me çështjet me objekt 'lejim lidhje martesë nën moshë'	15
1.2	Forma e kërimit në gjykatë: kërkesë kundrejt kërkesë padisë	16
1.3	Gjinia e personit për të cilin/ën kërkohet lidhja e martesës nën moshë	16
1.4	Subjekti kërkues për lejin e lidhjes së martesës nën moshë. Marrëdhënia e subjektit kërkues me të miturin/ën në rastet kur kërkesa nuk bëhet prej të miturit/ës: legjitimimi aktiv	17
1.5	Mosha e personit për të cilin/ën është bërë kërkesa dhe jepet vendimi për lidhjen e martesës nën moshë	18
1.6	Arsimimi i personit për të cilin/ën është bërë kërkesa dhe jepet vendimi për lidhjen e martesës nën moshë	19
1.7	Vendbanimi i personit të mitur ose kërkuesit jo të mitur në çështjet e lejitimit të lidhjes së martesës nën moshë	20
1.8	Numri i seancave dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor	21
2	Pjesëmarrësit në proces	23
2.1	Zyra e gjendjes civile dhe e personit madhor me të cilin po lidhet martesa	23
2.2	Roli/pjesëmarrja e psikologut	23
2.3	Roli i prindërve dhe shoqërimi i të miturit/ës në gjykatë nga të rritur të tjerë	23
2.4	Prania e mbrojtësit ligjor/Avokatit	24
3	Përmbajtja e vendimeve gjyqësore	25
3.1	Shkaku me rëndësi sipas kërkesës kundrejt shkakut me rëndësi sipas vendimit të gjykatës	25
3.2	Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin e gjykatës	25
3.3	Vlerësimi i pjekurisë fiziko-psikike të të miturit	25
3.4	Vlerësimi i të kuptuarit qartë të martesës dhe gadishmëria e të miturit/ës për të marrë përgjegjësi	25

II -	ANALIZA SOCIALE E MARTESAVE NËN MOSHË	
1	Analizë e gjetjeve me aspekt shoqëror në lidhje me martesat nën moshën e lejuar në Korçë dhe Pogradec	26
1.1	Karakteristikat demografike sipas hulumtimit në Korçë dhe Pogradec	26
1.2	Karakteristikat e historikut arsimor të grave të martuara nën moshë	29
1.3	Jeta familjare dhe statusi shoqëror i grave të martuara nën moshë	30
1.4	Arsyet e martesave nën moshë dhe lidhjes ligjore	32
1.5	Shkaku me rëndësi i vendimit të gjykatës	33
2	Shqetësimet kryesore për martesat nën moshë	34
III –	PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE KRYESORE	35
IV –	BIBLIOGRAFIA	37
V –	SHTOJCA	38

i. LISTA E SHKURTIMEVE

CEDAW	Konventa Për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CFLI	Fondi Kanadez për Nismat Lokale
GjEDNj	Gjykata Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut [Strasburg]
GjRrGj	Gjykata e Rrethit Gjyqësor
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve [1989]
KEDNj	Konventa Europiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut
KF	Kodi i Familjes miratuar me Ligjin Nr.9062/8.5.2003
KP	Kodi Penal i RSh miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar
KPrC	Kodi i Procedurës Civile të RSh miratuar me Ligjin Nr.8116/29.3.1996, i ndryshuar
KPrP	Kodi i Procedurës Penale të RSh miratuar me Ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
RSh	Republika e Shqipërisë

ii. LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1: Çështjet e pranuar për periudhën 2011-2016 në GjRrGj Korçë	15
Grafik 2: Çështjet e pranuar kundrejt atyre të pushuara për periudhën 2011-2016 në GjRrGj Korçë	15
Grafik 3: Çështjet e pranuar për periudhën 2011-2016 në GjRrGj Pogradec	16
Grafik 4: Grupmosha e të miturës sipas vendimeve në GjRrGj Korçë 2011-2016	18
Grafik 5: Përqindja e seancave gjyqësore për 20 çështjet e monitoruara në GjRrGj Korçë	21
Grafik 6: Numri i seancave gjyqësore për 20 çështjet e monitoruara në GjRrGj Korçë	21
Grafik 7: Zhvillimi i gjykimeve për lejim lidhje martesë llogaritur në ditë. Rasti i GjRrGj Korçë	21
Grafik 8: Numri i seancave gjyqësore për 9 çështjet e monitoruara në GjRrGj Pogradec	22
Grafik 9: Shoqërimi në gjykatë i të miturës sipas vendimeve të GjRrGj Korçë 2011-2016	23
Grafik 10: Shoqërimi në gjykatë i të miturës në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016	23
Grafik 11: Shkaku me rëndësi në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016	25
Grafik 12: Shkaku me rëndësi në vendimet e GjRrGj Korçë 2011-2016	25
Grafik 13: Mosha aktuale e të anketuarave - Dhjetor 2016	26
Grafik 14: Mosha e lindjes së fëmijës së parë sipas anketimit të Dhjetorit 2016.....	27
Grafik 15: Niveli i arsimimit të të anketuarave në Dhjetor 2016	29
Grafik 16: Shkollimi pas lindjes së fëmijës - Dhjetor 2016	30
Grafik 17: Prirjet profesionale sipas anketimit të Dhjetorit 2016	30
Grafik 18: Shkaqet e martesës nën moshë sipas anketimit të Dhjetorit 2016	32
Grafik 19: Shkaku për lejimin e martesës sipas Dhjetorit 2016	33

iii. LISTA E TABELAVE

Tabelë 1: Rastet sipas grupmohave të të miturve në vendimet e GjRrGj Korçë 2011-2016	18
Tabelë 2: Rastet sipas grupmohave të të miturve në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016	19
Tabelë 3: Kohëzgjatja e seancave në vendimet e GjRrGj Korçë 2011-2016	22
Tabelë 4: Kohëzgjatja e seancave në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016	22
Tabelë 5: Mosha e martesës së të miturve sipas anketimit të Dhjetorit 2016	26
Tabelë 6: Statusi i martesës sipas anketimit të Dhjetorit 2016	27
Tabelë 7: Mosha e prindërve të vajzave në martesë nën moshë sipas anketimit Dhjetor 2016	28
Tabelë 8: Lloji dhe statusi i familjeve ku janë rritur të anketuarat - Dhjetor 2016	28
Tabelë 9: Statusi i punësimit të prindërve të të miturve në Dhjetor 2016	29
Tabelë 10: Arsimi prindëror në Dhjetor 2016	29
Tabelë 11: Vitet e jetesës me familjen e bashkëshortit sipas pyetësorit të Dhjetorit 2016	31
Tabelë 12: Numri i fëmijëve të lindur pas të parit sipas pyetësorit të Dhjetorit 2016	31
Tabelë 13: Gjendja shëndetësore e fëmijëve sipas vlerësimit mëmësor në pyetësorin e Dhjetorit 2016	31
Tabelë 14: Problematika gjinore sipas pyetësorit të Dhjetorit 2016	32
Tabelë 15: Gjendja gjatë intervistimit në Dhjetor 2016	33

iv. FALËNDERIME

Ky raport hartohet në kuadrin e zbatimit të projektit Parandalimi i martesave të hershme duke zbatuar mekanizmat ligjorë dhe perceptimin social, si një mjet për fuqizimin e grave dhe vajzave (**PARANDALIM**). Projekti është zbatuar nga Observatori, përmes “monitorimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Korçë dhe Pogradec për periudhën 2011- 2016” dhe është mbështetur nga CFLI.

Dëshirojmë të falënderojmë CFLI që financoi monitorimin e vendimeve të gjykatave, përgatitjen e këtij raporti dhe të tryezës konsultative të post përgatitjes së raportit. E gjithë kjo nismë synon evidentimin e problematikës së praktikës gjyqësore dhe marrjen e masave të përshtatshme nga ana e sistemit të drejtësisë lidhur me fenomenin e martesave nën moshën 18 vjeç.

Observatori shpreh falënderimet dhe mirënjohjen ndaj Z. Admir Belishta Kryetar i GjRrGj Korçë dhe Znj. Emona Muçi Kryetare e GjRrGj Pogradec si dhe stafet administrative të këtyre gjykatave për gadishmërinë në dhënien e çdo informacioni lidhur me praktikën gjyqësore me objekt kërkesat për lidhjen e martesës nën moshë dhe për gjithë lehtësitë e krijuara në këtë proces.

Observatori dëshiron të shprehë mirënjohjen e veçantë dhe falënderimet e përzemërta për Prof.Dr Arta Mandro e cila hartoi tabelat, lëhtësoi kontaktet me gjykatën dhe përgatiti analizën ligjore të vendimeve të gjyqësorit në këtë raport. Falënderime të veçanta i drejtohen edhe Z. Bernard Zeneli, i cili përgatiti analizën sociale të martesave nën moshë.

Observatori shpreh falënderimet e sinqerta për ekipin e kësaj nisme edhe të monitoruesve të përbërë nga: Znj. Elma Tërshana, Znj. Eridjona Kica, Znj. Mariana Jorgji, Znj. Ina Zalllemi.

Observatori shpreson që gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e këtij raporti të jenë të dobishme dhe të gjejnë vend në zbatimin e tyre në praktikën gjyqësore dhe ndërgjegjësimin qytetar lidhur me rastet e martesave nën moshë si dhe do të nxisin angazhim edhe më të gjerë prej aktorëve të tjerë.

v. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport analizon aspektet ligjore dhe sociale të martesave nën moshë në Shqipëri. Raporti fokusohet në evidentimin dhe analizën e vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Korçë dhe Pogradec për periudhën 2011 - 2016. Raporti është kryer në kuadrin e projektit Parandalimi i martesave të hershme duke zbatuar mekanizmat ligjorë dhe perceptimin social, si një mjet për fuqizimin e grave dhe vajzave (PARANDALIM). zbatuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe është mbështetur nga CFLI.

Çka paraqitet në faqet në vijim është një analizë për evidentimin e problematikës së praktikës gjyqësore dhe marrjen e masave të përshtatshme nga ana e sistemit të drejtësisë lidhur me fenomenin e martesave nën moshë 18 vjeç. Ky raport analizon praktikën gjyqësore me objekt kërkesat për lidhjen e martesës nën moshë dhe sesi “martesa nën moshë” ka ndikuar në jetën sociale, familjare të të miturve.

Në Gjykatën e Rrethit Korçë dhe Pogradec, përgjatë periudhës 2011 – 2016, janë paraqitur 34 kërkesa për ‘lejim lidhje të martesës nën moshë’, nga të cilat 85.3% e kërkesave janë pranuar (29 kërkesa) dhe 14.7% e kërkesave janë pushuar (5 kërkesa).

Pjesa më e madhe e kërkesave për ‘lejim lidhje të martesës nën moshë’ janë paraqitur në vitin 2011 me 38% të rasteve, vijuar me vitin 2013 me 27% të rasteve. Ky fenomen ka ardhur duke u ulur në vitin 2016 me 14% të rasteve.

Në GjRrGj Korçë dhe Pogradec janë 22 raste ose 76% e rasteve të pranura në të cilat pretendentët për bashkëshort të ardhshëm jetojnë në Shqipëri. Ndërsa janë 7 raste ose 24% e rasteve të pranura pranë gjykatave në të cilat pretendentët për bashkëshort të ardhshëm jetojnë jashtë Shqipërisë.

Nga 29 vendime të pranura në GjRrGj Korçë dhe Pogradec për periudhën 2011 - 2016 rezultojnë se në 72% të rasteve nuk është bërë një vlerësim psikologjik i të miturit.

Në GjRrGj Korçë dhe Pogradec janë 12 raste ose 41% e rasteve me përfaqësimin e avokatit ndërsa në 15 raste ose 52% e rasteve nuk ka përfaqësim të avokatit. Në dy vendime të dhëna ose 7% e rasteve në GjRrGj Korçë nuk mund të merrej informacion lidhur me mbrojtësin ligjor.

Duke analizuar aspektin social të rasteve të martesave nën moshë, evidentohet shqetësimi se 65% e grave të intervistuar në Pogradec janë të divorcuara tashmë dhe ky divorc në 11 prej rasteve ka ndodhur pas 5 – 7 vitesh martesë. Situatë më solide me gjendjen e martesës paraqitet në Korçë me 5% të rasteve.

Shumica e të miturve që janë martuar nën moshë vijnë nga familje, prindërit e të cilave janë të papunë, mbi 50% e rasteve në Pogradec dhe mbi 75% e rasteve në Korçë. Papunësia është faktor shqetësues që reflektohet edhe në statusin e punësimit të grave të cilat janë martuar herët.

Migrimi i prindërve korrelohet si faktor i rëndësishëm në lidhje me martesat nën moshë në Korçë ku më shumë se gjysma e prindërve duket se kanë qenë në migrim (në Greqi). Në Pogradec nuk duket të jetë faktor shumë i rëndësishëm.

Në 91% të rasteve të të miturve në Pogradec, gratë janë me nivel të ulët arsimor, ndërsa në Korçë kjo shfaqet në 80% të rasteve. Ky konstatim përkon me të dhënat ndërkombëtare ku është identifikuar korrelacioni midis nivelit të ulët të arsimit dhe martesave nën moshë.

Pas lindjes së fëmijës as shkolla, as punësimi nuk duket të jenë përparësi në jetën e grave që martohen nën moshë. Shumica e grave në këtë lloj situatë sipas hulumtimit të kryer nuk punojnë jashtë shtëpisë. Në Korçë vetëm në një rast dikush punon jashtë shtëpisë ndërsa në Pogradec 75% e grave nuk janë të punësuar jashtë shtëpisë.

Numri më i lartë i aborteve dhe problemeve pasi fëmija i lindur ka qenë vajzë shfaqet në Pogradec. Në këtë bashki në 7 prej 22 raste lindjesh nënat e reja kanë pasur probleme për shkak të gjinisë së të porsalindurit. Edhe numri i aborteve të raportuara është 8 në 23 raste të pyetura për këtë gjë.

Rekomandojmë institucionet e gjykatës që ndër të tjera, një vëmendje duhet t'i kushtojnë interesit më të lartë të të miturit.

Reduktimi drejt eliminimit të martesave nën 16 vjeç duhet të jetë në vëmendje të të gjithë institucioneve dhe aktorëve lokalë apo qendrorë, duke përfshirë gjyqësorin dhe median. Të gjithë duhet të jemi ndihmës dhe aktorë për të mos lejuar në asnjë rast lidhjen e martesës nën moshë pavarësisht justifikimeve.

vi. ÇFARË ËSHTË OBSERVATORI?

Observatori është një entitet jo-fitimprurës shqiptar i themeluar në vitin 2013 si pjesë e rrjetit të shoqërisë civile që monitoron situatën e fëmijëve në vend. Nëpërmjet përfaqësuesve në nivel rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë vendore dhe institucionet e mirëqenies sociale, Observatori mbledh informacion mbi të dhënat nga rekordet administrative të shëndetit, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera lokale. Nëpërmjet përdorimit të sistemit DevInfo databaza e pasur dhe e konsoliduar me informacione statistikore është e aksesueshme online në faqen: <http://www.observator.org.al/odf-map/>

Nëpërmjet përdorimit të këtyre të dhënave, të cilat plotësohen me evidenca të nxjerra edhe nga pyetësorë, Observatori ka realizuar raporte të situatës së fëmijëve dhe ka kontribuar në planet e veprimit për fëmijët në nivel rajonal dhe qendror. Në vitin 2013, Observatori realizoi raportin e parë gjithëpërfshirës me dimensione të ndryshme të varfërisë dhe deprivimit të fëmijëve në Shqipëri.

Një tjetër evidencë e prezencës së fortë të Observatorit në terren ka qenë aftësia për të advokuar me autoritetet e qeverisë për rritjen e masave në adresimin e nevojave të fëmijëve dhe familjeve më vulnerabël.

Observatori kontribuon për të prodhuar dhe për të përdorur prova shkencore për formulimin e politikave të bazuara tek rezultatet dhe të qendëruara tek të drejtat e fëmijës. Observatori monitoron zbatimin e politikave kombëtare për mirëqenien e fëmijëve dhe të të rinjve, duke i'u referuar standardeve dhe politikave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Observatori, me mbështetjen e CFLI, ka realizuar dy studime mbi çështjen e martesave nën moshë:

- Studimi i parë Martesat e hershme në Shqipëri, një vështrim specifik i komunitetit Rom u realizua përgjatë periudhës Janar - Mars 2015 dhe u pilotua në 3 zona të Tiranës: Shkozë, Liqen dhe Qendra e Emergjencave. Versioni elektronik i studimit mund të gjendet në faqen zyrtare të Observatorit: http://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/03/2015-Martesat_e_hershme_ne_Shqiperi.pdf

- Studimi i dytë Zgjedhja e Lumturisë së Martesës së Hershme: Raste Studimore për Martesën e Hershme në Korçë dhe Vlorë u realizua në zonat e Korçës dhe Vlorës, duke e shtrirë fokusin e kësaj çështjeje në zonat rurale. Versioni elektronik i studimit mund të gjendet në faqen zyrtare të Observatorit: http://observator.org.al/wp-content/uploads/2016/02/ZEB_Studimi_al_12Shk2016.pdf

Ky raport ka për qëllim monitorimin e vendimeve gjyqësore të GjRrGj Korçë dhe Pogradec për periudhën 2011 - 2016, si edhe efektet sociale që kanë sjellë këto vendime në jetën e këtyre individëve. Observatori synon të angazhojë më tej institucionet e qeverisjes lokale dhe aktorëve kyç në një proces të bashkërenduar për të adresuar fenomenin e martesave nën moshë në shkallë kombëtare.

vii. METODOLOGJIA

Në kuadrin e zbatimit të projektit Parandalimi i martesave të hershme duke zbatuar mekanizmat ligjorë dhe perceptimin social, si një mjet për fuqizimin e grave dhe vajzave (PARANDALIM) zbatuar nga Observatori, me mbështetjen e CFLI është kryer një monitorim i vendimeve gjyqësore të GjRrGj Korçë e Pogradec për periudhën 2011 - 2016. Vendimet e monitoruara janë ato me objekt 'kërkesat për lidhjen e martesave nën moshë'. Për periudhën në fjalë, të tilla janë 20 vendime të pranuara dhe 1 i pushuar për GjRrGj Korçë, dhe 9 të pranuara dhe 4 të pushuara për GjRrGj Pogradec.

Në aspektin metodologjik, realizimi i këtij monitorimi përfshiu disa hapa kryesorë si:

- Identifikimi i gjykatave dhe vendosja e kontakteve me to: siç u përmend, monitorimi u përqendrua në GjRrGj Korçë e GjRrGj Pogradec;
- Evidentimi i situatës 'makro' lidhur me lidhjet e martesave nën moshë përmes pilotimit të kërkesave të paraqitura në total për periudhën 2011 - 2016;
- Përgatitja e tabelave me të dhënat me interes për monitorim sipas objektivit të çështjeve gjyqësore të monitoruara;
- Instruktimi i monitoruesve dhe puna me vendimet në terren;
- Sigurimi i kopjeve elektronike të vendimeve;
- Përpunimi i të dhënave;
- Përgatitja e raportit me analizat dhe rekomandimet përkatëse.

viii. Dy fjalë për kuadrin ligjor dhe standardet ndërkombëtare lidhur me 'martesën nën moshë'

E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të pasur familje është pjesë e të drejtave themelore të njeriut. Realizimi i kësaj të drejte ka kufizimet e veta ligjore. Një prej tyre është arritja e moshës madhore [shih neni 7 i KF]. Të tjera janë mungesa e pëlqimit të lirë [neni 8 KF], martesë ekzistuese nëse kërkohet të lidhet një martesë e re, sëmundje e rëndë psikike ose zhvillimi mendor i metë, i tillë që e bën të paaftë të kuptojë qëllimin e martesës, etj [shih neni 7-14 të KF]. Të gjitha rastet, përfshirë martesën nën moshë ose martesën pa pëlqimin e lirë, bëjnë që martesë e lidhur të jetë e pavlefshme. KF [2003] parashikon të njëjtat kushte dhe pengesa martesore për të dy bashkëshortët e ardhshëm. Po kështu, nuk ka asnjë dispozitë diskriminuese lidhur me moshën e martesës.

Por ndërsa, psh. pëlqimi i lirë nuk njeh kompromis ligjor dhe mbetet në çdo rast në vullnetin e bashkëshortëve për t'u verifikuar, mosha është një kriter objektiv dhe si e tillë plotësisht e matshme/verifikueshme edhe nga nëpunësi i gjendjes civile edhe nga gjykata në rast se kërkohet të lidhet martesë përpara moshës 18 vjeç. Sipas nenit 7 të KF: 'Martesë mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesë, për shkakë me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe'.

Fenomeni i martesave të të miturve, është ndër çështjet e trajtuara më shpesh nga Komiteti i KDF dhe Komiteti CEDAW në vërejtjet përfundimtare në dialogun e tyre me shtetet palë të këtyre instrumenteve. Të dy komitetet, përmes jurisprudencës së tyre lidhur me martesën e fëmijëve, theksojnë tiparet plotësuese dhe reciprokisht përforcuese të të dy Konventave sa i përket moshës së martesës. Ndërsa KDF nuk ndalon posaçërisht martesën e fëmijëve, por në mënyrë të qartë përcakton moshën madhore atë 18 vjeç, CEDAW kategorikisht e konsideron martesën e fëmijëve të pavlefshme ab initio. Martesat në moshë të mitur ndikojnë negativisht në realizimin e një sërë të drejtash të kësaj grupmoshe siç është e drejta për arsimim dhe kualifikim, zhvillim, argëtime etj.

Kur një i mitur kërkon të lidhë martesë nën moshë, kjo situatë nuk është më një kompetencë e nëpunësit të gjendjes civile. Në këto raste përjashtimore, një rol i veçantë i mbetet gjykatës. Gjykata, ndërsa është e ndërgjegjshme lidhur me moshën e mitur të kërkuesit, lipset të ndalet se sa rëndësi ka shkaku i paraqitur ose pretenduar për të lejuar lidhjen e martesës nën moshë kundrejt shkeljes së detyrimit ligjor të moshës për martesë. Sipas rastit, gjykata, duhet të verifikojë nëse qëndrojnë ose jo shkaqet me rëndësi dhe sipas rastit mund të lejojë ose jo këtë martesë. Në këtë rast gjykata merr përsipër një rol me rëndësi.

² Shih gjithashtu, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, neni 19.

³ Konventa CEDAW, Neni 16.1. Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë, do t'i sigurojnë grave mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave: ...b) Të drejtën e njëjtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet të lirë dhe të plotë; ...Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë asnjë efekt juridik, prandaj do të merren të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar.

Në rastet e lejimit të martesës nën moshë, gjykatës, 'i bie barra' të kuptojë:

- Sa reale janë shkaqet me rëndësi të pretenduara për lidhjen e martesës nën moshë kundrejt rrezikut të çenimit të standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe shkeljes së parimit të moshës për martesë;
- Sa mundësi ka që përmes gjykatës të ligjërohet ende zakoni dhe traditat e martesave pa pëlqim të lirë, ose të martesave me 'mblesëri a shkuesi', ose të martesave me detyrim;
- A ekziston pëlqimi i lirë i të miturit;
- A e kupton i mituri se çfarë është martesa, çfarë efektesh ka në të drejtat e tij/saj, etj.

Në Shqipëri janë ende evidente raste të martesave me mblesëri ose ndërmjetësim dhe ndaj gjykata, në raste të tilla, duhet të ketë parasysh se çfarë rreziqesh shfaq kjo lloj martesë në parimin e 'pëlqimit të lirë'. Në disa zona të vendit, zakonet dhe traditat e së shkuarës ende kanë një ndikim edhe më të madh.

Ajo që vihet re nga monitorimi i praktikës gjyqësore dhe analiza e vendimeve mbi lejin e lidhjes së martesës nën moshë, është se nuk ka asnjë rast që kërkesa për lidhjen e martesës nën moshë 'të jetë bërë për një burrë'. Gjithashtu, konstatohet se nuk ka asnjë rast rrëzimi të kërkesës për lidhjen e martesës nën moshë. Në këtë mënyrë duket sikur, shkaqet me rëndësi janë të lidhura vetëm me një gjini të caktuar dhe çojnë në rregullin e vjetër të diferencave në moshë lidhur me martesën. Gjithsesi, ajo që duhet të pranojmë, të paktën për këto dy rrethe të marra në analizë, është tendenca drejt uljes së numrit të kërkesave të tilla.

E drejta për të zgjedhur një bashkëshort/e dhe për të hyrë lirish në një martesë është me rëndësi për jetën, dinjitetin dhe barazinë e burrit dhe të gruas.

Sa më e vogël mosha, aq më e kufizuar autonomia për të vendosur dhe aq më i mundshëm imponimi apo detyrimi për martesë. Në rolin e vet gjykata kontrollon dhe mbron martesën si institucion, por edhe të drejtat e fëmijës që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Sipas Kushtetutës së RSh dhe dispozitave të KF, edhe martesa, edhe fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Gjykata që lejon martesën nën moshë ndërsa "ndërhyn" në realizimin e aktit të martesës, nuk mund të jetë aq sipërfaqësore sa të mos shohë përtej aktit. Garantimi i martesës si institucion është detyrë e rëndësishme që ligji në këtë situatë i'a ka deleguar gjykatës, e cila jep lejen mbi bazën e një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi ballafaquar këto me interesin më të lartë të të miturit dhe kuptimin e martesës.


Konventën e Këshillit të Europës e njohur si Konventa e Stambollit "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" ka tri nene me rëndësi që nevojitet të mbahen në vëmendje kryesisht në rastet e lidhjes së martesës nën moshë .

⁴ Neni 32 – Pasojat civile të martesave të detyruara: Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që martesat e detyruara të mund të jenë të pavlefshme, të anulohen ose zgjidhen pa barra të papërshtatshme financiare ose administrative të vendosura ndaj viktimës. Neni 59/4 - Statusi i vendbanimit: 4. Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e martesës së detyruar të sjellë në një shtet tjetër, për qëllim martesë dhe të cilët, si rezultat, kanë humbur statusin e tyre të vendbanimit në shtetin ku ata zakonisht banojnë, mund të rifitojnë këtë status. Neni 37 – Martesa e detyruar: 1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e detyrimit të qëllimshëm të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë. 2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e tërheqjes së qëllimshme të një të rrituri ose fëmije për të shkuar në territorin e një Pale ose Shteti të ndryshëm nga ai ku ai ose ajo banon, me qëllim detyrimin e një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

I - ANALIZA LIGJORE E VENDIMEVE TË GJYQËSORIT

1. GJETJE KRYESORE NGA MONITORIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË GJRRGJ KORÇË DHE POGRADEC ME OBJEKT 'LIDHJE MARTESE NËN MOSHË' PËR PERIUDHËN 2011-2016


1.1 Të dhëna të përgjithshme lidhur me çështjet me objekt 'lejim lidhje martesë nën moshë'



Grafik 1: Çështjet e pranuar për periudhën 2011-2016 në GjRrGj Korçë

Për periudhën 2011-2016, pranë GjRrGj Korçë janë paraqitur 22 kërkesa për 'lejim lidhje të martesës nën moshë' nga të cilat 20 të pranuar, vetëm 1 [një] çështje është pushuar dhe 1 [një] është kthyer për shkak të të metave. Nuk ka asnjë çështje të rrëzuar nga kjo gjykatë. Kjo do të thotë që gjykata ka gjetur shkaqe me rëndësi në çdo kërkesë të paraqitur dhe kështu ka lejuar lidhjen e martesës nën moshë.

Tabela/ grafiku i dytë paraqet numrin e kërkesave për lejim lidhje martesë nën moshë sipas viteve të monitoruara nga Observatori, pra nga 2011 deri në 2016. Siç vihet re, numrin më të madh të kërkesave për GjRrGj Korçë e kemi në vitin 2011 me 8 të tilla. Grafiku paraqet trendin e kërkesave në këtë gjykatë për periudhën e monitoruar [përkatësisht vija e ndërprerë me pika], duke na paraqitur kështu, sipas të dhënave të gjykatës, një trend në ulje. Nga vendimet e administruara në GjRrGj Korçë ka një vendim për pushimin e çështjes, dhe siç rezulton nga kontrolli i bërë në vendimet e kësaj gjykatë, kërkesja, deri në dhjetor 2016, nuk i është drejtuar gjykatës përsëri për të kërkuar lejimin e martesës nën moshë. Vendimi mban datën 23.09.2015 dhe kërkesja është e datëlindjes 27.06.2002 që do të thotë, që ka 3 muaj që ka festuar datëlindjen e 13-të.




Grafik 2: Çështjet e pranuar kundrejt atyre të pushuara për periudhën 2011-2016 në GjRrGj Korçë

*Kërkesja nuk ka vendosur adresën e saj me qëllim që prej gjykatës të bëhet njoftimi për seancat gjyqësore.

*Vendimi nr 1630/23.09.2015 i GjRrGj Korçë

Për GjRrGj Pogradec nga 13 kërkesa të paraqitura në total për lejim lidhje të martesës nën moshë, janë pranuar 9 dhe janë pushuar 4 çështje. Gjithashtu, edhe këtu nuk ka asnjë kërkesë të rrëzuar nga gjykata. Vëmë re se nga vendimet e administruara gjatë monitorimit ndër 4 çështjet e pushuara, në 2 prej tyre është bërë përsëri kërkesa për lejim lidhje të martesës nën moshë. Duket sikur palët nga 2 deri në 4 mujor. Ndërkohë vihet re se të dyja rastet kur është vendosur pushimi dhe mandej është hapur procesi përmes rikërkesës, çështja është gjykuar nga i njëjti gjyqtar çka e bën edhe më të rëndësishëm rolin e gjykatës në vlerësimin e pëlqimit të lirë përmes një hetimi më të plotë. Në një prej vendimeve, e mitura, kërkon të lidhë martesë sepse pas përfundimit të shkollës së mesme dëshiron të vijojë studimet jashtë shtetit, aty ku jeton 'i fejuari'.



Grafik 3: Çështjet e pranuar për periudhën 2011-2016 në GjRrGj Pogradec

Do të ishte me vend që në raste të tilla me objekt lejim lidhje martesë nën moshë ku çështjet pushohen dhe mandej kërkohen, gjykata të bënte një hetim më të kujdesshëm mbi vullnetin e të miturës dhe pëlqimin e lirë duke siguruar seanca pyetjeje pa praninë e të afërmeve që mund të influencojnë në vendim-marrje.

1.2 Forma e kerkimit në gjykatë: kërkesë kundrejt kërkesë padisë

Në të gjitha rastet e paraqitura në gjykata, qoftë të GjRrGj Korçë ose GjRrGj Pogradec, vihet re se gjykatat janë vënë në lëvizje përmes kërkesës. Lejimi i lidhjes së martesës nën moshë është proces që zhvillohet pa palë kundërshtare. Pra, vihet re se është kuptuar drejt nga pikëpamja procedurale paraqitja e një kërkesë për të vënë në lëvizje gjykatën.

1.3 Gjinia e personit për të cilin/ën kërkohet lidhja e martesës nën moshë

Në të gjitha vendimet gjyqësore të periudhës 2011-2016, për GjRrGj Korçë ose GjRrGj Pogradec është kërkuar lejimi i lidhjes së martesës nën moshë për bashkëshortin e ardhshme dhe në asnjë rast për bashkëshortin e ardhshëm. Të krijohet përshtypja se përjashtimi nga rregulli mbi lejimin e lidhjes së martesës nën moshë është një artificë për të ulur moshën për martesë të grave dhe një kthim, përmes vendimit të gjykatës, në rregullin e mëparshëm lidhur me martesën ku gruaja mund të lidhte martesë 16 vjeç dhe burri 18 [KF 1982]. Ajo që mbetet shqetësuese është se ka raste që kërkohet dhe lejohet martesë edhe për të mitura nën 16 vjeç.

⁷ Shih Vendimin nr.715/27.6.2011 ku është vendosur për pushimin e çështjes dhe Vendimin nr.1013/12.10.2011 ku është vendosur për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë për të njëjtën të mitur. Shih gjithashtu Vendimin nr.1026/25.10.2013 ku është vendosur për pushimin e çështjes dhe Vendimin nr.1213/26.12.2013 ku është vendosur për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë për të njëjtën të mitur dhe si shkak me rëndësi është vazhdimi i studimeve pas përfundimit të shkollës së mesme.

1.4 Subjekti kërkues për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë. Marrëdhënia e subjektit kërkues me të miturin/ën në rastet kur kërkesa nuk bëhet prej të miturit/ës: legjitimimi aktiv

Për GjRrGj Korçë, nga 20 çështjet e pranuar, në 18 prej tyre kërkesa është bërë nga e mitura dhe në 2 prej tyre kërkues është personi madhor i cili ka pretenduar në këtë kërkim që të jetë bashkëshorti i ardhshëm i të miturës. E mitura ka paraqitur kërkesë edhe në çështjen e pushuar dhe atë të kthyer për shkak të të metave.

Për GjRrGj Pogradec të gjitha kërkesat për lejim të lidhjes së martesës nën moshë, 13 total përfshi edhe vendimet e pushimit, kërkuese ka qënë e mitura.

Çështjet e legjitimitit aktiv të të miturit/ës që kërkon të lidhë martesë nën moshë janë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i Kodit të Procedurës Civile. Pra, gjykata, sikurse është vepruar edhe në këto 18 raste të GjRrGj Korçë dhe 13 raste të GjRrGj Pogradec, vihet në lëvizje prej vetë të interesuarës, që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Ky qëndrim i ligjit dhe i praktikës gjyqësore është plotësisht i justifikuar nëse bëhet fjalë për lejim lidhje martese. Duke qënë se martesa është një akt personal, përfaqësimi në gjykatë nuk do të ishte korrekt. Ashtu sikurse nuk ka lidhje martese me përfaqësim përpara nënpunësit të gjendjes civile, e njëjta vlen për paraqitjen e kërkesës në gjykatë. Që të lejojë lidhjen e martesës nën moshë, gjykata duhet të vlerësojë të miturin/ën personalisht, pëlqimin e lirë dhe shkakun që për atë të mitur ka rëndësi. Gjykata nuk bën vlerësime në përgjithësi lidhur me ato që përbëjnë 'shkak me rëndësi' për lidhjen e martesës por i sheh ato në raport me të miturin/ën, pjekurinë e tij/saj fiziko-psikike, pëlqimin e lirë, gadishmërinë për të marrë përsipër përgjegjësitë e martesës, etj.

Pra, lidhja e martesës nën moshë investon gjykatën si një autoritet që bën vlerësimin rast pas rasti të shkakut si dhe të kushteve e ndalesave të tjera të parashikuara në KF lidhur me lidhjen e martesës për atë të mitur që ka paraqitur kërkesën.

Prindi, sipas KF, ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Atëherë kjo është një arsye më shumë që prindi të mos legjitimohet aktivisht të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësisë prindërore.


Po kështu, edhe bashkëshorti i ardhshëm, edhe nëse ky është madhor, nuk mund t'i drejtohet i vetëm gjykatës për të kërkuar lidhjen e martesës së tij me të miturën. Në vendimin nr. 1288/30.5.2013 kërkues është pikërisht pretendenti për bashkëshort i ardhshëm ndërsa e mitura është thirrur si person i tretë për të cilën bëhet kërkesa për martesë. Gjithashtu, nga ky vendim del se i ati i të miturës ka qënë prezent ne seancën gjyqësore. Praktika gjyqësore njeh raste të shtrëngimit ose detyrimit për martesë dhe, që të përjashtohet çdo rrezik si dhe të eliminohet cënimi i të drejtave të të miturit/ës, kërkohet që i/e mituri/a, lejimi i martesës të së cilit/ës po çmohet nga Gjykata, të paraqitet personalisht me cilësinë e kërkueses.

Në një prej këtyre vendimeve të GjRrGj Korçë, ku kërkesa për lejim lidhje martese nën moshë është bërë nga pretendenti për bashkëshort, nuk del e qartë nëse e mitura është paraqitur dhe pyetur përpara gjykatës. Bëhet fjalë për vendimin nr 2443/26.10.2011 në të citohet se e mitura është intervistuar nën praninë e psikologes të thirrur nga gjykata me qëllimin e pyetjes së të miturës mbi këtë kërkesë. Ndërkohë, gjykata, në këtë çështje, është shprehur për ekzistencën e pëlqimit të lirë nga ana e pretendentit për bashkëshort çka pa dyshim ka rëndësinë e vet, por që nuk mund të zëvendësojë në asnjë rast vlerësimin nga gjykata të të miturës. Pra, në vendimet gjyqësore, nevojitet të shprehet qartazi kujdesi për të miturën. A po e kupton e mitura kërkesën që ka paraqitur dhe ndryshimet që sjell në jetën e vet? A po e kupton procesin?

⁹ Shih Vendimin nr.2443/26.10.2011 dhe vendimi 1288/30.5.2013 i GjRrGj Korçë.

Nuk duket korrekte që e mitura të thërritet me cilësinë e personit të tretë kur në fakt procesi fillim e mbarim është për të. Për këtë na vijnë në ndihmë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë në procesin civil për të kuptuar se e mitura nuk mund të ketë kurrësi atë pozicion procedural. Në një prej këtyre rasteve, e mitura është vetëm 15 vjeçe e më pak se 2 muaj dhe në tjetrin rast 16 vjeçe e 5 muaj. Pra, autonomia e saj, e thirrur si e tretë është pothuaj zero. Është gjithnjë babai që jep pëlqimin, bashkëshorti i ardhshëm, por ajo vet nuk duket protagoniste në martesën e saj.

1.5 Mosha e personit për të cilin/ën është bërë kërkesa dhe jepet vendimi për lidhjen e martesës nën moshë



Grafik 4: Grupmosha e të miturës sipas vendimeve të GjRrGj Korçë 2011-2016

Në çdo rast është fjala për të mitura nën 18 vjeç. Mosha e të miturës na lejon të kuptojmë, veç qëndrimit të gjykatës, atë të shoqërisë në tërësi. Pra a ka një koncept social, përtej të cilit nuk mund të bëhet një kërkesë për lejim lidhje të martesës nën moshë?

Meqë flasim për kufij moshe sensitivë, tabela në vijim na ndihmon për të kuptuar më qartë grupmoshën e të miturës për të cilën kërkohet lejimi i martesës nën moshë.

Siç vihet re, për GjRrGj Korçë numrin më të madh e zë grupmosha nga 16 deri në 17 vjeç me 10 raste, pasuar nga grupmosha mbi 17 vjeç me 8 raste. Janë vetëm 2 vendime që lejojnë lidhje të martesës nën moshë për një nënë 16 vjeçare. Në një prej rasteve e mitura është pjesëtare e komunitetit Rom dhe vendimi paraqet traditën e këtij komuniteti në lidhjen e martesave nën moshë nën kufijtë e lejuar nga ligji.

GjRrGj Korçë		
Grupmosha deri në 16 vjeç - 2 raste	Grupmosha deri në 17 vjeç - 10 raste	Grupmosha mbi 17 vjeç - 8 raste
[1] 15 vjet e 10 muaj; [2] 15 vjet e 1 muaj e 20 ditë	[1] 16 vjet e 5 muaj e 19 ditë; [2] 16 vjet e 10 muaj 16 ditë; [3] 16 vjet e 5 muaj 13 ditë; [4] 16 vjet e 7 muaj e 8 ditë; [5] 16 vjet e 2 muaj [6] 16 vjet e 5 muaj 17 ditë; [7] 16 vjet e 5 muaj 7 ditë; [8] 16 vjet e 10 muaj 22 ditë; [9] 16 vjet e 26 ditë; [10] 16 vjet e 1 vjet 1 muaj 22 ditë;	[1] 17 vjet; [2] 17 vjet 1 muaj; [3] 17 vjet 7 muaj; [4] 17 vjet 5 muaj 24 ditë; [5] 17 vjet 2 muaj 5 ditë; [6] 17 vjet 5 muaj 20 ditë; [7] 17 vjet 5 muaj 21 ditë; [8] 17 vjet 2 muaj 25 ditë;

Tabelë 1: Rastet sipas grupmoshave të të miturve në vendimet e GjRrGj Korçë 2011-2016

Për GjRrGj Pogradec numrin më të madh e zë grupmosha mbi 17 vjeç me 4 raste, pasuar nga grupmosha mbi 16 vjeç me 3 raste. Janë vetëm 2 vendime që lejojnë lidhje të martesës nën moshë për një nënë 16 vjeçare.

GjRrGj Pogradec		
Grupmosha deri në 16 vjeç - 2 raste	Grupmosha deri në 17 vjeç - 3 raste	Grupmosha mbi 17 vjeç - 4 raste
[1] 15 vjet e 4 muaj; [2] 15 vjet e 1 muaj e 20 ditë	[1] 16 vjet 5 muaj; [2] 16 vjet 6 muaj; [3] 16 vjet 11 muaj;	[1] 17 vjet 3 muaj; [2] 17 vjet 3 muaj; [3] 17 vjet 6 muaj; [4] 17 vjet 2 muaj

Tabelë 2: Rastet sipas grupmoshave të të miturve në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016

Siç vihet re, në gjykatë paraqiten kërkesa edhe për lidhjen e martesës së të miturve nën moshën 16 vjeç. Është e vërtetë që dispozitat e KF nuk parashikojnë një moshë minimum, nën të cilën nuk mund të lejohet lidhja e martesës as me vendim gjykate, por gjykata ka gjithë diskrecionin, dhe duhet të ushtrojë kujdes maksimal në raste të kërkesave të tilla dhe do të rekomandohej që kërkesa të tilla të gjenin një trajtim të veçantë edhe duke përfshirë autoritete lokale që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me qëllim ndërgjegjësimin dhe parandalimin e martesave nën moshë të hershme.

1.6 Arsimimi i personit për të cilin/ën është bërë kërkesa dhe jepet vendimi për lidhjen e martesës nën moshë

Kjo e dhënë nuk del shumë e qartë në të gjitha vendimet e monitoruara për GjRrGj Korçë. Kështu nga 20 vendime të pranuar, vetëm në 3 prej tyre kemi të dhëna lidhur me arsimimin e subjektit për të cilin kërkohet lejimi i lidhjes së martesës nën moshë. Vendimet bëjnë fjalë për të mitura me arsim 9 vjeçar në 2 raste dhe arsim deri në klasën 10-të në një rast.

Do të ishte me interes nëse kjo e dhënë pasqyrohej në të gjitha vendimet gjyqësore. Kjo do të mundësonte konkluzione lidhur me të drejtën për arsim dhe impaktin e lidhjes së martesës. Gjithashtu do të ishte me interes të mësohej nëse kemi raste të kërkesave për lejim martese nën moshë për të mitur pa asnjë arsim. Martesat në moshë të mitur efektojnë negativisht në realizimin e të drejtave të tjera të kësaj grupmoshe dhe e drejta për arsimim dhe kualifikim është një prej tyre.

Sa i përket GjRrGj Pogradec, nga 9 vendime, vetëm në 1 prej tyre kemi të dhëna lidhur me arsimimin e subjektit për të cilin kërkohet lejimi i lidhjes së martesës nën moshë. Në këtë rast e mitura është duke ndjekur arsimin e mesëm.

Në paragrafin 30, të Vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW të vitit 2010 dhe në mënyrë të përsëritur në paragrafin 20 dhe 21 të Vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW të vitit 2016 për Shqipërinë, shprehet shqetësim i lidhur me numrin e madh të largimeve nga shkolla, veçanërisht në nivelin e mesëm edhe për shkak të martesave të parakohshme, martesat e fëmijëve, zgjedhja e bashkëshortit nga familja dhe pagesa e një çmimi ose prike për nusen, një fenomen ky që është mbizotërues në zonat rurale dhe të largëta dhe në radhët e komuniteteve të vogla. Kjo duhet të tërheqë vëmendjen e gjyqësorit shqiptar për rastet kur kërkohet lidhja e martesës nën moshë e cila ka impakt negativ në arsimimin e vajzave. Në këtë mënyrë, në vendime të tilla, arsimimi i të miturës/it që kërkon të lidhë martesë nën moshë duhet të jetë jo vetëm i pasqyruar në vendimet gjyqësore, por edhe në vëmendje të gjykatës lidhur me realizimin e kësaj të drejte kur lejohet lidhja e martesës nën moshë.

Duke iu referuar rekomandimit të përgjithshëm Nr. 31 të Komitetit CEDAW dhe komentit të përgjithshëm Nr. 18 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve për praktikën e dëmshme (2014), Komiteti CEDAW gjithashtu rekomandon që vendi ynë të ndalojë të gjitha praktikën e dëmshme, ku përfshihen martesat e fëmijëve, praktika e familjeve që zgjedhin bashkëshortin për vajzën e tyre, etj.

1.7 Vendbanimi i personit të mitur ose kërkuesit jo të mitur në çështjet e lejimit të lidhjes së martesës nën moshë

Sipas vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë, rezultojnë se ka një përqindje të balancuar sa i përket vendbanimit të subjektit për të cilin po kërkohet lejimi i lidhjes së martesës nën moshë. Kështu, në 10 raste vendbanimi i të miturës është në zonat rurale dhe 10 të tjera në ato urbane. Lidhur me të rriturin kërkues, që del në 2 vendime nga 20 totali, del se ai është pretendenti për bashkëshort dhe e ka vendbanimin në Korçë dhe nga të dhënat e vendimit rezultojnë me status beqar.

Për GjRrGj Korçë janë 5 raste ose 25% e rasteve të pranuar pranë kësaj gjykate në të cilat pretendentët për bashkëshort të ardhshëm jetojnë jashtë Shqipërisë. Kështu:

- Me vendbanim Itali është një rast ;
- Me vendbanim Greqi janë 2 raste ;
- Me vendbanim Maqedoni janë 2 raste

Sipas vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec, sikurse nënvizuar edhe më sipër, në të gjitha rastet subjekti kërkues është vet e mitura. Sa i përket vendbanimit të të miturës kërkuese, vendimet e gjykatës paraqesin raportin 6 me 3 në favor të vendbanimit 'fshat'. Pra, më së shumti kërkohet të lidhet martesa nën moshë për të mitura me vendbanim në zonat rurale. Lidhur me vendbanimin e personit me të cilin e mitura kërkon të lidhë martesë, të paktën në 2 raste, ai jeton jashtë vendit përkatësisht në Itali dhe Gjermani.

Në GjRrGj Pogradec, në 4 raste të të miturve me vendbanim në fshat, nga 6 në total, pretendenti për bashkëshort jeton në fshat. Një një rast të të miturës me vendbanim në fshat nuk del vendbanimi i pretenditit për bashkëshort. Në 1 rast të të miturës me vendbanim në fshat pretendenti për bashkëshort jeton në Gjermani.

Në GjRrGj Pogradec, 2 raste të martesës së të miturëve me vendbanim, nga 3 në total, në qytet pretendenti për bashkëshort është nga qyteti dhe në një prej rasteve ai ka letra qëndrimi në Itali. Në 1 rast të të miturës me vendbanim në qytet pretendenti për bashkëshort jeton në fshat.

E konsideruar me interes ndikimin e vendbanimit të bashkëshortit të ardhshëm në nxitjen e lidhjes së këtyre martesave. Sepse, në rastet kur përmes martesës kërkohet lëvizja jashtë shtetit, kujdesi i gjykatës për të miturën duhet të jetë edhe më i madh. Konventa e Këshillit të Europës e njohur si Konventa e Stambollit "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", përkatësisht neni 32 mbi pasojat civile të martesave me detyrime dhe neni 37 mbi martesat me detyrim i kërkon shteteve palë të bëjnë kujdes dhe të marrin gjithë masat për detyrimin për martesë dhe pavarshmërinë e këtyre martesave.


¹⁰ Shih Vendimin nr.31/07.01.2011 i GjRrGj Korçë

¹¹ Shih Vendimin nr.1461/07.09.2016 dhe Vendimin nr.2673/14.11.2011 i GjRrGj Korçë


¹² Shih Vendimin nr.2163/03.10.2011 dhe Vendimin nr.2208/21.12.2015 i GjRrGj Korçë

¹³ Shih Vendimin nr.59/23.03.2016 për vendbanimin në Itali dhe Vendimin nr.652/26.12.2013 për vendbanimin në Gjermani i GjRrGj Pogradec

1.8 Numri i seancave dhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor




Grafik 5: Përqindja e seancave gjyqësore për 20 çështjet e monitoruara në GjRrGj Korçë



Grafik 6: Numri i seancave gjyqësore për 20 çështjet e monitoruara në GjRrGj Korçë

Koha e paraqitjes së kërkesës për lejim martesë nën moshë, është një tjetër e dhënë e nxjerrë nga monitorimi i vendimeve gjyqësore.

Gjykimet e kërkesave për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë, përgjithësisht, zhvillohen në pak seanca. Kështu, në 20 çështje të monitoruara në GjRrGj Korçë, për 9 kërkesa ose 45% të tyre janë zhvilluar vetëm 2 seanca; për 6 kërkesa ose 30% të çështjeve ka mjaftuar vetëm një seancë. Pra, thënë ndryshe 75 % e kërkesave janë vlerësuar brenda 1-2 seancave gjyqësore. Pjesa tjetër, pra 25% ose 5 çështjet, janë vendosur brenda 3 ose 4 seancave. Për më shumë detaje shih tabelat bashkëlidhur.



Grafik 7: Zhvillimi i gjykimeve për lejim lidhje martesë llogaritur në ditë. Rasti i GjRrGj Korçë

Observatori monitoroi jo vetëm numrin e seancave, por edhe shtrirjen kohore, në ditë, të gjykimeve me këtë objekt. Vihet re se, në rreth 12 çështje gjykimi ka zgjatur nga 10 ditë minimumi në 35 ditë maksimumi.

Në 4 çështje, kohëzgjatja është nga 36-60 ditë dhe në 4 çështje e gjykimit shkon deri në 120 ditë.

Jo në të gjitha rastet, ka një përputhje midis numrit të seancave dhe kohëzgjatjes së proceseve. Për këtë këndvështrim na ndihmojnë të dy tabelat përbri ku sipas çështjeve [20 në Korçë dhe 9 në Pogradec] del lidhja midis seancave dhe ditëve të gjykimit. Psh, për GjRrGj Korçë çështjet me 1 seancë kanë një kohëzgjatje nga 15 ditë në 1 muaj e 20 ditë, sikurse çështje të zhvilluara në 2 seanca kanë një kohëzgjatje edhe 10 ditë.


Lidhur me GjRrGj Pogradec nga 9 vendime, rreth 45% e tyre ose 4 çështje kanë marrë kohën e 3 seancave; vetëm 1 çështje është shqyrtuar në 6 seanca; 2 çështje janë zhvilluar në 2 seanca dhe 2 të tjera në 1 seancë.

GjRrGj Korçë	
Seancat	Kohëzgjatja
3	1 muaj e 20 ditë
1	27 ditë
1	15 ditë
1	15 ditë
2	26 ditë
3	1 muaj e 5 ditë
1	1 muaj e 12 ditë
1	17 ditë
2	1 muaj
2	1 muaj e 4 ditë
3	1 muaj e 13 ditë
2	10 ditë
2	2 muaj e 7 ditë
2	22 ditë
2	19 ditë
4	2 muaj e 22 ditë
4	3 muaj e 4 ditë
2	4 muaj e 3 ditë
2	1 muaj e 4 ditë
1	1 muaj e 20 ditë

Tabelë 3: Kohëzgjatja e seancave në vendimet e GjRrGj Korçë 2011-2016

GjRrGj Pogradec	
Seancat	Kohëzgjatja
3	23 ditë
1	19 ditë
2	2 muaj 19 ditë
1	18 ditë
2	20 ditë
3	1 muaj e 7 ditë
3	1 muaj e 21 ditë
3	1 muaj 8 ditë
6	3 muaj

Tabelë 4: Kohëzgjatja e seancave në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016



Grafik 8: Përqindja e seancave gjyqësore për 9 çështjet e monitoruara në GjRrGj Pogradec

2. PJESËMARRËSIT NË PROCES

2.1 Zyra e gjendjes civile dhe personi madhor me të cilin po lidhet martesa

Sipas vendimeve të monitoruara në GjRrGj Korçë të periudhës 2011-16, rezultojnë se nga 20 vendime të pranuar për lejimin e martesës, në vetëm 6 prej tyre është thirrur Zyra e Gjendjes Civile si palë e tretë. Në të gjitha këto raste, rezultojnë se Zyrat e Gjendjes Civile kanë marrë njoftimin për paraqitje rregullisht përmes fletëthirrjeve. Megjithatë rezultojnë se në të 6 rastet, Zyrat e Gjendjes Civile (Pirg, Vreshtas, Bulgarec dhe Korçë) nuk janë paraqitur. Ndërkohë, nga 20 vendime të pranuar për lejimin e martesës, në 12 raste pretendenti për bashkëshort i ardhshëm ka qenë palë e tretë.


Sipas vendimeve të monitoruara në GjRrGj Pogradec të periudhës 2011-16, rezultojnë se në asnjë prej 9 vendimeve të pranuar për lejimin e martesës nuk është thirrur Zyra e Gjendjes Civile si palë e tretë. Ndërkohë, nga 9 vendime të pranuar për lejimin e martesës në 5 raste pretendenti për bashkëshort i ardhshëm ka qenë palë e tretë.

2.2 Roli/pjesëmarrja e psikologut


Nga 20 vendime të GjRrGj Korçë të periudhës 2011-16 rezultojnë se në 12 raste nuk është bërë një vlerësim psikologjik i të miturit. Në 2 vendime nuk del e qartë nëse ka ose nuk ka një vlerësim psikologjik. Në pjesën tjetër të vendimeve të kësaj gjykate, pra 6 vendime, del qartë i pasqyruar roli i psikologut dhe vlerësimi psikologjik bërë prej tij/saj lidhur me të miturin.

Nga 9 vendime të GjRrGj Pogradec të periudhës 2011-16 ose në 100% të tyre, rezultojnë se në asnjë prej tyre nuk është bërë një vlerësim psikologjik i të miturit.

2.3 Roli i prindërve dhe shoqërimi i të miturit/ës në gjykatë nga të rritur të tjerë



Grafik 9: Shoqërimi në gjykatë i të miturës sipas vendimeve të GjRrGj Korçë 2011-2016



Grafik 10: Shoqërimi në gjykatë i të miturës në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016

Sipas të dhënave të monitoruara, në vendimet e GjRrGj Korçë, rezultojnë se në 50% të rasteve e mitura shoqërohet vetëm nga nëna. Këto përbëjnë edhe shumicën e rasteve pranë kësaj gjykate. E mitura shoqërohet nga të dy prindërit dhe kjo ka dalë në 30 % të rasteve, ndërsa në 10% të rasteve vetëm nga babai. Gjithsesi ka një vendim ku e mitura është shoqëruar nga të rritur të

tjerë siç janë prindërit e bashkëshortit të ardhshëm si dhe një rast në të cilin nuk shprehet nëse e mitura është shoqëruar nga prindërit apo pretendenti për bashkëshort të ardhshëm .

Për GjRrGj Pogradec në 9 vendimet e lejimit të martesës në moshë për periudhën 2011-16 vëmë re se në 44.5% të rasteve e mitura është shoqëruar vetëm nga nëna dhe po kaq është frekuenca e shoqërimit edhe vetëm nga babai. Në 11% të rasteve kanë qënë të pranishëm të dy prindërit.

2.4 Prania e mbrojtësit ligjor/Avokatit

Rezulton se nga 20 vendime të GjRrGj Korçë, në 8 prej tyre kemi përfaqësimin me avokat ndërsa në 10 raste nuk ka përfaqësim me avokat. Në dy vendime të dhëna, nuk mund të merrej informacion lidhur me mbrojtësin ligjor.


Nga 9 vendime të GjRrGj Pogradec, në 4 prej tyre kemi përfaqësimin me avokat ndërsa në të tjerat, pra 5 raste, nuk ka përfaqësim me avokat.

Nuk mundet të verifikohet sa në dijeni janë të miturit për të përdorur aksesin në gjykatë përmes ndihmës ligjore falas.


¹⁴ Shih vendimin 1428/07.06.2011 i GjRrGj Korçë

3. PËRMBAJTJA E VENDIMEVE GJYQËSORE

Shtatëzania dhe lindja e fëmijës janë ato që janë konsideruar si shkaqet me rëndësi sipas vendimit të Gjykatës. Kështu GjRrGj Korçë ka vendosur të lejojë lidhjen e martesës nën moshën ligjore ku shkaku kryesor është ose shtatëzania [në 17 raste] ose lindja e fëmijës [në 3 raste].



Grafik 11: Shkaku me rëndësi në vendimet e GjRrGj Pogradec 2011-2016



Grafik 12: Shkaku me rëndësi në vendimet e GjRrGj Korçë 2011-2016

Sa i përket shkakut me rëndësi të pasqyruar në kërkesën e paraqitur në gjykatë konstatohet se për GjRrGj Korçë, të njëjtat shkaqe gjenden dhe në kërkesën e paraqitur nga palët.

Për GjRrGj Pogradec veç lindjes së fëmijës [2 vendime] dhe shtatëzanisë [5 vendime] na del edhe një shkak tjetër që nuk e kemi hasur më parë [në 2 vendime të tjera]: ‘për të vazhduar studimet e larta jashtë shtetit përkatësisht në Itali dhe në Gjermani meqë aty është ‘i fejuari’.

3.2 Vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës në vendimin e gjykatës

Vetëm në 14 vendime ose në 70% të totalit të vendimeve të GjRrGj Korçë, gjykata është shprehur lidhur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Në 6 vendime të tjera nuk gjendet një analizë e tillë. Në të gjithë vendimet e GjRrGj Pogradec, nga ana e gjykatës është bërë një vlerësim lidhur me parimin e interesit më të lartë të të miturës.

3.3 Vlerësimi i pjekurisë fiziko-psikike të të miturit

Në 11 vendime të GjRrGj Korçë, gjykata është shprehur lidhur me pjekurinë fiziko-psikike të të miturës për të cilën po disponon me vendim lejimin e martesës nën moshë. Në 9 të tjera nuk gjendet një analizë e tillë. Në 3 vendime të GjRrGj Pogradec, gjykata është shprehur lidhur me pjekurinë fiziko-psikike të të miturës.

3.4 Vlerësimi për të kuptuar qartë martesën dhe gadishmëria e të miturit për të marrë përgjegjësi

Në 19 vendime të GjRrGj Korçë, gjykata është shprehur lidhur me vlerësimin e të miturës sa i përket kuptimit të qartë të martesës dhe gadishmërisë së të miturit për të marrë përgjegjësi. Në 1 rast nuk gjendet një analizë e tillë.

Në të gjithë vendimet e GjRrGj Pogradec nga ana e gjykatës është bërë një vlerësim lidhur me sa e qartë është martesa për të miturën dhe sa e gatshme është e mitura të marrë përgjegjësitë që burojnë nga martesa.

II - ANALIZA SOCIALE E MARTESAVE NËN MOSHË


1. ANALIZË E GJETJEVE ME ASPEKT SHOQËROR NË LIDHJE ME MARTESAT NËN MOSHËN E LEJUAR NË KORÇË DHE POGRADEC

1.1 Karakteristikat demografike sipas hulumtimit në Korçë dhe Pogradec

Janë intervistuar 49 femra në lidhje me iniciativën e marrë për martesën nën moshë. Në Korçë janë intervistuar 23 gra nga martesa nën moshë, ndërsa në Pogradec numri i të anketuarve ishte 26. Të gjitha gratë që janë intervistuar janë martuar para moshës tetëmbëdhjetë vjeçare.

1.1.1 Mosha aktuale e të intervistuarve

Grupmosha dominuese e grave të martuara nën moshë është mes moshës 19 dhe 25 vjeç, duke përfaqësuar mbi 70% të kampionimit. Në Pogradec, kjo grupmoshë përbën shumicën dominuese të të anketuarve, ndërsa në Korçë grupmosha duket edhe më e re.



Grafik 13: Mosha aktuale e të anketuarave - Dhjetor 2016

1.1.2 Mosha kur janë martuar të anketuarat


Shumica e të anketuarve janë martuar gjatë moshës 16- 17 vjeç. Kjo është grupmosha dominante me përkatësisht 70% të rasteve në Pogradec dhe 90% të rasteve në Korçë, ose 34 raste së bashku. Shqetësuese është situata në 9 raste, që i përkasin moshës 15 vjeç ose më poshtë.

Mosha kur jeni martuar:	Pogradeci	Korça
14 vjeç	1	0
15 vjeç	6	2
16 vjeç	10	10
17 vjeç	6	8

Tabelë 5: Mosha e martesës së të miturve sipas anketimit të Dhjetorit 2016

1.1.3 Mosha që kanë sjellë në jetë fëmijën e parë

Shumica e grave të martuara nën moshë janë tashmë nëna. Në kampionin e Pogradecit në 74% të rasteve fëmija i parë ka ardhur në jetë kur nëna i përkiste grupmoshës 15 – 16 vjeç. Në Korçë kjo përqindje është vetëm 33% ose në gjashtë raste. Një situatë e kundërt evidentohet në këto dy zona në lidhjen e shkakësisë mes martesës dhe shtatzanisë. Në 78% të rasteve në Pogradec, martesa ka pasuar lindjen e fëmijës së parë, kurse në Korçë kjo situatë është e kundërt – në 90% të rasteve martesa ka ndodhur para lindjes së fëmijës së parë.



Grafik 14: Mosha e lindjes së fëmijës së parë sipas anketimit të Dhjetorit 2016

1.1.4 Statusi aktual i të martuarave nën moshë

Në hulumtimin tonë me shqetësim përmendim faktin se 65% e grave të intervistuar në Pogradec janë të divorcuara tashmë dhe ky divorc në 11 prej rasteve ka ndodhur pas 5 – 7 vitesh martesë. Situatë më solide me gjendjen e martesës paraqitet në Korçë.

Statusi aktual ligjor:	Pogradeci	Korça
E martuar	30%	95%
E divoruar	65%	5%
E ve	4%	0%
Beqare	0%	5%

Tabelë 6: Statusi i martesës sipas anketimit të Dhjetorit 2016

1.1.5 Diferenca në moshë me bashkëshortët

Në Korçë diferenca e moshës bashkëshortore varion nga 3 deri në 18 vjet dhe dominon diferenca në moshë nga 6 deri në 10 vjet me 50% të rasteve. Në Pogradec diferenca në moshë e çiftit është më e ulët dhe mbi 90% e të anketuarve paraqesin një diferencë moshe me bashkëshortin nga 1 deri në 5 vjet.

1.1.6 Mosha e prindërve të të intervistuarve

Prindërit e grave të intervistuar duket se janë mes moshës 35 dhe 59. Në Pogradec 60% e prindërve meshkuj i përkasin moshës 51 – 60 vjeçare, ndërsa në Korçë kjo masë përqindje i korrespondon grupit të prindërve femra të moshës 41 – 50 vjeçare.

1. Mosha e prindërve (vjeç)	Pogradeci	Korça
1.a Mosha e nënës		
40 vjeç	4	4
50 vjeç	10	12
60 vjeç		
70 vjeç	1	1
1.b Mosha e babait		
40 vjeç		
50 vjeç	4	9
60 vjeç	13	8
70 vjeç	3	0

Tabelë 7: Mosha e prindërve të vajzave në martesë nën moshë sipas anketimit Dhjetor 2016

1.1.7 Lloji i familjeve

Situata e të intervistuarve tregon se në Korçë vajzat janë të rritura në familje me dy prindër. Në Korçë vetëm 2 nga të anketuarat vijnë nga familje me një prind, ndërsa në Pogradec mbi 50% e të anketuarve i përkasin familjeve me një prind ose prindër të ndarë.

Lloji i familjes:	Pogradeci	Korça	Gjendja ligjore e prindërve	Pogradeci	Korça
Me të dy prindërit	8	17	Beqare	1	0
Me njërin prind	5	2	Martuar	11	15
Me prindër të ndarë	10	0	Divorcuar	11	0
Me prindër të rimartuar	0	0	I/e Ve	0	1

Tabelë 8: Lloji dhe statusi i familjeve ku janë rritur të anketuarat - Dhjetor 2016

1.1.8 Statusi i punësimit të prindërve

Shumica e prindërve e të intervistuarve janë të papunë, me mbi 50% e rasteve në Pogradec dhe mbi 75% e rasteve në Korçë. Papunësia është një faktor shqetësues i cili reflektohet edhe në statusin e punësimit të grave të martuara nën moshë.

Çiftit është më e ulët dhe mbi 90% e të anketuarve paraqesin një diferencë moshe me bashkëshortin nga 1 deri në 5 vjet.

A janë të punësuar prindërit tuaj:	Pogradeci	Korça
Po	11	5
Jo	12	15

Tabelë 9: Statusi i punësimit të prindërve të të miturve në Dhjetor 2016


1.1.9 Migrimi i prindërve

Migrimi i prindërve korrelohet si faktor i rëndësishëm në lidhje me martesat nën moshë në Korçë ku më shumë se gjysma e prindërve duket se kanë qenë në migrim (në Greqi). Migrimi i prindërve në Pogradec nuk duket të jetë faktor shumë i rëndësishëm. Vendi që predominon në emigrim është Greqia me 16 raste në të dy bashkitë.

1.2 Karakteristikat e historikut arsimor të grave të martuara nën moshë

1.2.1 Niveli i arsimimit

Gratë me nivel të ulët arsimor dominojnë grupin e të anketuarve në të dy bashkitë, përkatësisht me 91% të rasteve në Pogradec dhe 80% të rasteve në Korçë. Në të dhënat ndërkombëtare evidentohet një korrelacion midis nivelit të ulët të arsimimit dhe martesave nën moshë. Nga krahasimi i nivelit arsimor të prindërve me atë të intervistuarve evidentohet një rritje shumë e vogël e numrit të viteve të kaluara në arsim të të intervistuarve në krahasim me prindërit. Përputhja e nivelit të edukimit të të intervistuarve me atë të prindërve të tyre mund të jetë domethënëse e shpjegues për shkakësinë e martesës para moshës së lejuar.




Grafik 15: Niveli i arsimimit të të anketuarave në Dhjetor 2016

Niveli i arsimimit të prindërve:	Pogradeci	Korça
Pa arsim	2	2
Fillor	18	6
8 vjeçar	1	7
I mesëm	2	2
I lartë	0	1

Tabelë 10: Arsimi prindëror në Dhjetor 2016

1.2.2 Arritjet dhe rezultatet në shkollë


Shumica e të intervistuarve tregojnë për rezultate mesatare ose të dobëta në shkollë. Në Korçë si ato me rezultate mesatare si dhe ato me rezultate të dobëta përbëjnë respektivisht 37% të grupit të anketuar. Në Pogradec numri i atyre me rezultate shkollore të dobëta shkon në 41%, por vlen të theksohet edhe njëherë niveli shumë i ulët në ndjekjen e shkollës. Po ashtu pjesa më e madhe e të anketuarave nuk i janë kthyer shkollës pasi kanë nxjerrë në jetë fëmijën e tyre të parë siç tregon edhe grafiku në vijim.



Grafik 16: Shkollimi pas lindjes së fëmijës - Dhjetor 2016

1.2.3 Prirjet profesionale

Shumica e grave në këtë lloj situatë sipas hulumtimit të kryer nuk punojnë jashtë shtëpisë. Në Korçë vetëm në një rast dikush punon jashtë shtëpisë, ndërsa në Pogradec 75% e grave nuk janë të punësuar jashtë shtëpisë. Shpërndarja e interesave pas mëmësisë nuk është aspak e qartë siç e tregon edhe grafiku në vijim. Në heshtje këto shifra janë alarmante, por duhet të merren parasysh në nivel kombëtar në mënyrë që të zhvillohen strategji adekuatë dhe të duhura për të korrigjuar këtë situatë.



Grafik 17: Prirjet profesionale sipas anketimit të Dhjetorit 2016

1.3 Jeta familjare dhe statusi shoqëror i grave të martuara nën moshë

1.3.1 Bashkëjetesa me prindërit e bashkëshortit

Ndërkohë familjet që kanë origjinën nga martesë nën moshë bashkëjetojnë me prindërit e bashkëshortit në gjysmën e rasteve të intervistuar. Po ashtu duket se familjet e lindura si shkak i martesës nën moshë, bashkëjetojnë me prindërit e familjes së bashkëshortit për një periudhë deri në të paktën dy vjet pas lindjes së fëmijës së parë. Ne na rezultojnë se pas vitit të pestë të martesës familjet e krijuara nga martesat nën moshë jetojnë më vete ekonomikisht. Këto të dhëna kërkojnë studime më të thelluara nga institucionet për të kuptuar më mirë dinamikën e familjes së “madhe” shqiptare gjatë dekadës së fundit.

Vitet që keni jetuar me familjen e	Pogradeci	Korça
1 vitë	7	6
5 vite	6	5
5+ vite	1	0

Tabelë 11: Vitet e jetesës me familjen e bashkëshortit sipas pyetësorit të Dhjetorit 2016

1.3.2 Numri i fëmijëve

Në Pogradec predominojnë familjet me një ose dy fëmijë, ndërsa në Korçë predominojnë familjet me një fëmijë. Ky rend tregon se edhe në këto lloj familjesh shkohet drejt konceptit të familjes bërthamë.

Sa fëmijë të tjerë keni lindur pas fëmijës së parë?	Pogradeci	Korça
	5	10
1	9	6
2	7	0
3	0	0
4	1	0

Tabelë 12: Numri i fëmijëve të lindur pas të parit sipas pyetësorit të Dhjetorit 2016

1.3.3 Gjendja shëndetësore e fëmijëve

Kur i kemi pyetur të intervistuarat për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të fëmijëve të tyre informacioni që morëm ishte pozitiv në të gjitha rastet në Korçë dhe në shumicën dominuese të rasteve në Pogradec siç e tregon edhe tabela në vijim. Mund të veçojmë 5 raste të fëmijëve në Pogradec, gjendja shëndetësore e të cilëve paraqitet keq.

Si është gjendja shëndetësore e fëmijës/ëve?	Pogradeci	Korça
Shumë e mirë	0	14
E mirë	17	3
Keq	5	0
Shumë keq	0	0

Tabelë 13: Gjendja shëndetësore e fëmijëve sipas vlerësimit mëmësor në pyetësorin e Dhjetorit 2016

1.3.4 Statusi familjar i të intervistuarve pas lindjes së fëmijës së parë

Përmes këtij raporti jemi përpjekur të hedhim dritë edhe mbi qëndrimin kundrejt lindjes së fëmijëve të seksit femër dhe lidhjes së numrit të dështimeve me gjininë. Numri më i lartë i aborteve dhe problemeve pasi fëmija i lindur ka qenë vajzë shfaqet në Pogradec. Në këtë bashki në 7 raste lindjesh ose 31% të tyre, nënat e reja kanë pasur probleme për shkak të gjinisë së të porsalindurit. Ndërsa numri i aborteve të raportuara është 8 raste ose 35% e rasteve. Në një mënyrë shumë të guximshme gratë që kemi intervistuar i janë përgjigjur pyetjeve në lidhje me detyrimin për të kryer abort. Për të ruajtur konfidencialitetin pyetjet e mëtejshme në lidhje me abortin nuk u bënë, por situata e Pogradecit përbën një tjetër shqetësim, ku vetëdija ka nevojë të rritet më tej në lidhje me këto çështje dhe në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore.

Nëse keni lindur vajzë, a ka pasur probleme?	Pogradeci	Korça
Po	7	0
Jo	15	11
A jeni detyruar të kryeni abort (dështim) të fëmijës?	Pogradeci	Korça
Po	8	1
Jo	15	16


Tabelë 14: Problematika gjinore sipas pyetësorit të Dhjetorit 2016

1.3.5 Rritja e fëmijës

Të afërmit dhe familjarët ndihmojnë nënat e martuara në moshë në procesin e rritjes së fëmijës. Në shumë pak raste ata mbështeten nga institucionet shëndetësore apo arsimore (çerdhet) në vetëm 3 raste në Korçë, pasi shumica e tyre nuk punojnë jashtë shtepisë.

1.4 Arsyet e martesave nën moshë dhe lidhjes ligjore

Shumica e të intervistuarve janë përgjigjur se arsyeja kryesore e martesave nën moshë lidhet me rënien në dashuri në 37% të rasteve) 16 raste. Gjithashtu vëmë re se disa prej tyre përmendin varfërinë dhe gjendjen e vështirë ekonomike si shkaqe dytësore. Mentaliteti dhe zakonet kulturore gjithashtu duket të luajnë një rol në vendimin për t'u martuar shumë herët, një situatë që është në të kundërt me të dhënat kombëtare duke raportuar një rritje në moshën për t'u martuar për të dyja gjinitë.



Grafik 18: Shkaqet e martesës nën moshë sipas anketimit të Dhjetorit 2016


Gratë e martuara nën moshë ishin shpesh si të përhumbura për pyetjet në lidhje me statusin e tyre ligjor dhe të drejtat e tyre pas emancipimit ligjor për shkak të martesës. Edhe pse nuk ishte ushtruar dhunë apo detyrim në procesin e martesës në gjykatë, shumica e grave në procesin e intervistimit kanë treguar intensitet të lartë emocional dhe kanë përmendur edhe përdorimin e dhunës në të paktën gjashtë raste.

E intervistuar a ka treguar shenja të shqetësimit emocional?	Pogradeci	Korça
Po	17	0
Jo	6	20
A është dëmtuar fizikisht ose sulmuar?	Pogradeci	Korça
P	5	1
Jo	18	19

Tabelë 15: Gjendja gjatë intervistimit në Dhjetor 2016

1.5 Shkaku me rëndësi i vendimit të gjykatës

Të dhënat e martesave nën moshë në këtë raport tregojnë se ky fenomen është një nënrymë me kah të kundërt që po bëhet më i fortë, dhe si e tillë meriton vëmendjen e shoqërisë dhe politikëbërësve. Shtatzënia si dhe lindja e një fëmijë janë parë si një justifikim për të lejuar martesën nën moshë. Për t'u theksuar janë edhe 5 rastet (4 në Pogradec dhe 1 në Korçë) ku gjykata ka legjitimuar martesën për bërjen e dokumentave për bashkim familjar, ndërkohë që bashkëshorti jetonte jashtë.



Grafik 19: Shkaku për lejimin e martesës sipas Dhjetorit 2016

2. SHQETËSIMET KRYESORE PËR MARTESAT NËN MOSHË

Edhe në këtë studim vazhdojnë të jenë prezente një pjesë e mirë e shqetësimeve të identifikuar në studimin "Zgjëndrra e lumturisë së martesës së hershme: Raste studimore për martesën e hershme në Korçë dhe Vlorë" realizuar në Janar 2016, të renditura më poshtë:

1. Martesat nën moshë në Shqipëri vazhdojnë të konsiderohen një praktikë tradicionale dhe si të tilla vazhdojnë të jenë të pranishme në vend.
2. Vajzat e reja ndikohen që të besojnë se siguria ekonomike dhe "jeta e rehatshme" që po i ofrohet janë faktorët kryesorë që do t'i sigurojnë një jetë të lumtur, kjo sidomos në rastet kur dhëndrri është emigrant. Ato nuk detyrohen të martohen me burra të panjohur, por është e qartë se pëlqimi i palëve të përfshira për t'u martuar apo bashkëjetuar është marrë nga presioni familjar ose ndonjëherë edhe nga zbatimi i ligjit sidomos në rastet kur martesa nën moshë vjen si pasojë e shtatëzanisë së paplanifikuar.
3. Tranzicioni drejt një shoqërie më të hapur nuk është shoqëruar me masat e sigurisë, veçanërisht në aspektin e planifikimit familjar dhe edukimit seksual. Martesa konsiderohet si një zgjidhje e artë edhe para presionit për vajzat për të dhënë pëlqimin për martesë apo bashkëjetesë menjëherë sapo shtatzënia/marrëdhënia bëhet publike. Në një rast të tillë, ka një tendencë për të mos e konsideruar martesën si një praktikë korruptive dhe të paligjshme.
4. Gratë e martuara nën moshë nuk kthehen në shkollë dhe shumica e tyre nuk kanë menduar për të patur një jetë profesionale sidomos pas lindjes, duke u përkushtuar vetëm në familje dhe në ambjentet e shtëpisë.
5. Vetë komuniteti e pranon këtë fenomen dhe shkollat dhe institucionet e tjera sociale nuk duken të përgatitura për të adresuar çështjen e martesave nën moshë: si parandalimin e tyre ashtu edhe procesin e riintegritimit të grave të grave të martuara nën moshë.
6. Çështja e martesave nën moshë nuk duket të ketë marrë vëmendjen e duhur nga aktorët e qeverisë pasi nuk duket të jetë pjesë e ndonjë strategjie.
7. Ndërgjegjësimi dhe trajnimi mbi dukurinë e martesës nën moshë nuk është realizuar në masën e duhur nga shoqëria civile dhe organizatat e grave. Ky ndërgjegjësim duhet të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me pushtetin vendor.
8. Mungon ndjeshmëria dhe vetëdija kritike nga ana e medias në trajtimin e çështjeve që lidhen me seksualitetin e fëmijëve dhe me martesat nën moshë. Nevoja për trajnimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në raportimin e këtyre çështjeve është e domosdoshme.
9. Martesat nën moshë për qëllime emigrimi konsiderohen si një hap i rëndësishëm në fillimin e një jete të lumtur dhe të rehatshme për të miturën, por ndodh shpesh që ato të bëhen dramatike dhe kthehen në abuzime dhe shfrytëzim seksual.

III. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE KRYESORE

Në vijim po rendisim disa nga rekomandimet që çojmë të jenë në vëmendje të gjykatës në rastin e lejimit të lidhjes së martesës nën moshë.

- Për gjykatën, mbajtja në vëmendje e interesit të të miturit, duhet të jetë konsiderata kryesore dhe ky kujdes i veçantë nevojitet të pasqyrohet në mënyrë sa më të qartë përmes analizës konkrete sipas rastit, në përmbajtjen e vendimit.
- Vetëm i mituri që kërkon të lidhë martesë nën moshë është ai që legjitimohet aktivisht në bërjen e kërkesës.
- Prindi, sipas KF, ka të drejtën e kundërshtimit të martesës. Në këto kushte nuk mund të jetë ai që vepron në emër të të miturit dhe nuk mund të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësisë prindërore.
- Legjislacioni shqiptar nuk e njeh pranimin ose pëlqimin e prindërve si detyrim për lidhjen e martesës nën moshë. Duke qenë se prindërit kanë të drejtën e kundërshtimit të martesës, vlerësimi i mendimit të tyre nga ana e gjykatës duhet bërë kundrejt interesit të të miturit dhe për të parë sa ndikim kanë prindërit në cënimin e vullnetit të lirë.
- Bashkëshorti i ardhshëm nuk mund të legjitimohet aktivisht, në lejin e lidhjes së martesës në moshë. Ky është subjekt që nevojitet domosdoshmërisht të thërritet në proces me cilësinë e personit të tretë.
- Parim shumë i rëndësishëm që duhet të mbahet nën kontroll nga ana e gjykatës është autonomia e vullnetit të të miturit/ës që kërkon leje për lidhjen e martesës nën moshë. Për të vlerësuar këtë vullnet, i mituri duhet të jetë prezent personalisht gjatë gjithë procesit. Gjykata duhet të garantojë të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe informuar, gjykata të mbajë në vëmendje se sa më e vogël mosha aq më lehtë manipulimi i të miturit në lidhjen e martesës pa pëlqimin e lirë.
- Gjykata që investohet për lejin e martesës nën moshë, e jep vendimin pas një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi të pretenduara; arsimi jashtë shtetit mund të sigurohet edhe pa lidhur detyrimisht martesën me një person që jeton jashtë shtetit; raste të tilla duhet të monitorohen me kujdes sepse mund të jenë burim shfrytëzimi, trafikimi, punë e detyruar, etj
- Nëse gjykata e çmon, i mituri mund të pyetet veçmas. Gjykata është e inkurajuar të marrë mendimin e të miturit në kushte ku nuk ka asnjë ndikim ndaj tij/saj. Pra i mituri nevojitet të merret në pyetje jo në prani të prindërve, kujdestarit ose bashkëshortit të ardhshëm dhe të të rriturve të tjerë; një listë pyetjesh e gatshme mund të lehtësojë gjykatën në komunikimin me të miturin për të kuptuar lirinë e vullnetit dhe aspekte të tjera.
- Gjykata nevojitet të verifikojë dhe pasqyrojë në vendim pjekurinë fiziko-psikike të personit nën moshën 18 vjeç që bën kërkesë për lidhje martese nën moshë. Për këtë ajo mund të përpilojë një listë me pyetje edhe të thjeshta për të parë reagimin e të miturit. Pjekuria psikike përfshin qartësinë e kërkesit/es lidhur me rëndësinë e martesës në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve. Pjekuria psikike duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre. Gjykata në këtë vendimmarrje duhet të mbrojë të miturin dhe martesën. Duke qenë se nga martesa lindin të drejta, detyrime e përgjegjësi, gjykata duhet të vlerësojë se sa në harmoni është personi me pjekurinë e vet kundrejt këtyre të drejtave dhe detyrimeve që imponon martesa dhe të informojë të miturin.
- Gjykata nevojitet të verifikojë rëndësinë e motivit/shkakut të pretenduar dhe që shoqëron kërkesën për lejin e lidhjes së martesës nën moshë. Motivi duhet trajtuar në raport me atë se çfarë i shtyn subjektet të kërkojnë lejen e gjykatës për lidhjen e martesës përpara kohe dhe jo sipas rregullave të martesës. Duhet të ketë arsye të mira për të lidhur këtë martesë. A po lidhet martesa nga turpi? Presioni? Nevoja ekonomike? Detyrimi? Etj.

¹⁵ Një pjesë e rekomandimeve janë marrë nga botimi i autores Arta Mandro Balili "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij". Botim i SHM dhe UNDP. Tiranë, Prill 2014. Fq 46-78.

- Gjykata nevojitet të verifikojë bazueshmërinë e motivit. Është ky një motiv fiktiv apo real? Kjo realizohet përmes pyetjeve. Nëse është real sa i bazuar është për të bërë një kërkesë në shkelje të rregullit të përgjithshëm të moshës? Arsytet duhet të jepen qartë. Ato duhet të jenë konkrete e reale. Pas shkaqeve që justifikohen si të rëndësishme mund të qëndrojnë të tjera që mund të sjellin rrezik për të miturin/ën.
- Marrja e mendimit të psikologut lidhur me anën psikologjike, pëlqimin e lirë dhe situatën sociale është një detyrim ligjor dhe ndihmesë e madhe për gjykatën që të japë një vendim të drejtë dhe të gjykojë mbi rëndësinë e shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre si dhe pjekurinë fiziko-psikike duke e bërë këtë verifikim edhe përmes psikologut. Gjykata edhe në gjykime të tilla duhet të respektojë parimin e nenit 6 të Kodit të Familjes dhe të KDF sipas të cilit: “Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën sociale”. Një rol të veçantë ndihmës për gjykatën në vendimarrje të tilla mund të luajnë Njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel vendor si edhe punojësit social.
- Reduktimi drejt eliminimit të martesave nën 16 vjeç duhet të jetë në vëmendje të gjykatës dhe të bëhet praktikë e saj. Pra, në asnjë rast, të mos lejohet lidhja e martesës nën këtë moshë pavarësisht justifikimeve.
- Gjykata nevojitet të mbajë në vëmendje se të miturat me gjendje të vështirë ekonomike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të martesave fiktive apo premtimeve për martesë që përfundojnë në shfrytëzim për prostitucion, trafikim ose çdo lloj forme tjetër shfrytëzimi.
- Në këndvështrimin e legjislacionit, ende ka vend për përmirësime përsa i përket legjitimitetit aktiv të të miturës dhe përcaktimit të një moshe minimum nën të cilën nuk mund të lejohet për asnjë arsye martesa nën moshë. Gjithashtu, shumë nga sugjerimet e përfshira në këtë dokument, mund të shoqërohen edhe me përmirësime ligjore. Mbetet ende me rëndësi për qasja me standardet ndërkombëtare të cituara në raport.

IV. BIBLIOGRAFIA

Konventa CEDAW "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas"

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Konventa e Këshillit të Europës e njohur si Konventa e Stambollit "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"

Prof. Dr. Arta Mandro Balili (Prill 2017) "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore. Roli i gjyqësorit shqiptar në eliminimin e tij", Botim i Shkollës së Magjistraturës dhe UNDP, Fq 46-78

V. SHTOJCA

Shtojca A: *Formati i pyetësorit mbi të dhënat me interes për monitorim sipas objektit të çështjeve gjyqësore të monitoruara*

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Numri i vendimeve sipas viteve					
Lloji i vendimit	2011	2012	2013	2014	2015
Pranuar					
Pranuar					
Rëzuar					
Inkompetencë					
Refuzuar					

II. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Çështje të pranura Të dhëna lidhur me çdo vendim të pranuar							
	Data e Kërkesës	Data e nr. i vendimit	Nr. i seancave	Koha e gjykimit	Forma e kërkesës	Shkaku në kërkesë	Shkaku në vendim
1							
2							
3							
4							

1. Data, muaji, viti i vendimit përfundimtar
2. Numri i seancave
 - a. Shëno nr e seancave
3. Kohëzgjatja e gjykimit
 - a. Në ditë
 - b. Në muaj
4. Forma e paraqitjes së kërkesës përpara gjykatës
 - a. Kërkesë
 - b. Kërkesë padi
5. Shkaku me rendësi i vendosur prej kërkuesit/shkaku që legjitimon kërkesën
6. Shkaku me rendësi i vendimit të gjykatës

III. TË DHËNA LIDHUR ME TË MITURIN/ËN

Të dhëna lidhur me të miturin/ën									
Gjinia		Mosha	Vendbanimi			Arsimi			
			Qytet	Fshat	?	Pa arsim	I detyruar	i mesëm	Nuk del
M	F								

7. Gjinia e të miturit
 - a. M
 - b. F
8. Mosha e saktë
 - a. Shëno sa vjeç e sa muaj
9. Vendbanimi
 - a. Qytet
 - b. Fshat
 - c. Nuk del në vendim
10. Arsimitimi
 - a. Pa arsim
 - b. I detyruar
 - c. I mesëm
 - d. Nuk del në vendim

Të dhëna lidhur me kërkuesin					
Nr	Kërkuesi	Gjinia	Gjendja civile	Vendbanim	Arsim

11. Plotësimi i kolonës 1: Kush e paraqet kërkesën. Lidhja gjinore mes të miturit dhe kërkuesit

- a. Vet i mituri
- b. Nëna
- c. Babai
- d. Kujdestari
- e. Gjyshi/gjyshja
- f. Të afërm të tjerë [specifiko]
- g. Nuk del në vendim

12. Plotësimi i kolonës 2: Gjinia e kërkuesit jo të mitur

- a. M
- b. F

13. Plotësimi i kolonës 3: Gjendja civile e kërkuesit jo të mitur

- a. VI martuar
- b. I divorcuar
- c. I ve
- d. Nuk del në vendim

14. Plotësimi i kolonës 4: Vendbanimi i kërkuesit jo të mitur

- a. Qytet
- b. Fshat
- c. Nuk del në vendim

15. Arsimitimi i kërkuesit jo të mitur

- a. Pa arsim
- b. I detyruar
- c. I mesëm
- d. I lartë
- e. Nuk del në vendim

V. TË DHËNA LIDHUR ME PROÇESIN, MBROJTJEN ETJ

Të dhëna lidhur me procesin , mbrojtjen						
Nr	Përfaqësimi me avokat		Psikologu		Shoqërimi	
	Po	Jo	Po	Jo	Po kush?	Jo
1						
2						
3						
4						

16. Përfaqësimi me avokat

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk del në vendim

17. Prania e psikologut

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk del në vendim

18. Shoqërimi i të miturit në proces nga të rritur të tjerë

- a. Po [kush]
- b. Jo

VI. VLERËSIMI I INTERESIT TË TË MITURIT NGA GJYKATA

- 19. Cituar parimi i interesit më të lartë të fëmijës
- 20. Analizuar pjekuria fizike e psikike
- 21. Analiza për të kuptuar qartë martesën dhe gadishmëria e të miturit për të marrë përgjegjësi

SHTOJCA B: PYETËSOR MBI MARTESAT NËN MOSHË



PYETËSOR

MBI MARTESAT NËN MOSHË

Ky pyetësor është realizuar nga **Observatori për të Drejtat e Fëmijëve** (Observatori) në kuadër të projektit "Ndalimi i martesave të hershme duke zbatuar mekanizmat ligjore dhe perceptimin social si mjete për fuqizimin e vajzave dhe grave (**NDALIMI**)", përgjatë periudhës tetor 2016- shkurt 2017, financuar nga Fondi Kanadez për Iniciativat Lokale. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i Fondit Kanadez për Iniciativat Lokale. Pyetësori ka si qëllim analizimin e jetës sociale dhe rasteve të martesave nën 18 vjeç të cilat janë lejuar në vendimet e gjykatave të rrethit Korçë dhe Pogradec. Pyetësori do të plotësohet nga individët të cilët janë martuar nën moshë në mënyrë ligjore në zonat e përzgjedhura, duke u bazuar në vendimet e gjykatave të rrethit Korçë dhe Pogradec. Pyetësori do të plotësohet përgjatë periudhës Dhjetor 2016. Të dhënat personale të këtij pyetësori janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllim analize sasiore të studimit. Gjetjet dhe analizat e studimit do të bëhen publike me qëllim për të ndikuar në proceset politik-bërëse lokale, në faqen zyrtare të Observatorit, si organizatë zbatuese: www.observator.org.al

TË DHËNA:

Intervistues

I intervistuar (Firmë)

Data -----

FORMULARI I PRANIMIT

Unë jam dakord që të marrë pjesë në pyetësorin që Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori) po realizon mbi martesat e hershme në rrethet e Korçës dhe Pogradecit.

Unë jam shpjeguar dhe e kuptoj se pyetësori është duke u zhvilluar me të vetmin qëllim për përmirësimin e ndërhyrjeve të hershme dhe gjenerimin e ideve të ardhshme të programit, në lidhje me përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve, ndërsa të dhënat e mia personale nuk do të zbulohen.

Unë jam dakort që të dhënat e plotësuara në pyetësor do të përdoren vetëm nga zyra e Observatorit për përdorim të brendshëm dhe qëllime kërkimore.

SESIONI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI TË ANKETUARIT

Data: _____

Qyteti: _____

1. Emër Mbiemër: _____

2. Adresa: _____

3. Mosha aktuale: _____

4. Statusi aktual:

- a) E martuar
- b) E divorcuar
- c) E ve
- d) Beqare

5. Lloji i familjes:

- a) Me të dy prindërit
- b) Me njërin prind
- c) Me prindër të ndarë
- d) Me prindër të rimartuar

6. Numri i motrave dhe vëllezërve në familje: _____

7. Radha e lindjes në familje:

- a) Fëmija i parë
- b) Fëmija i dytë
- c) Fëmija i tretë
- d) Fëmija i _____
- e) Fëmija i fundit

8. Mosha kur jeni martuar: _____

9. Numri i fëmijëve: _____

10. Mosha kur është lindur fëmija i parë: _____

11. Martesa ka ndodhur

- a) Para lindjes së fëmijës
- b) Pas lindjes së fëmijës

Nëse përgjigja është a, kaloni në pyetjen 12. Nëse përgjigja është b, kaloni në pyetjen

13

12. A është bërë shkak lindja për t'u martuar?

- a) Po
- b) Jo

13. Ju jetoni:

- a) Vetëm si çift
- b) Bashkë me prindërit e bashkëshortit ose tuajt

14. Nr i viteve që keni jetuar me familjen e bashkëshortit përpara se të lindnit fëmijën: _____

15. Diferenca në moshë me bashkëshortin: _____

SESIONI II: INFORMACION MBI EFEKTET SOCIALE TË MARTESAVE NËN MOSHË

NËNKATEGORIA A E SESIONIT II- INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI ARSIMIN

Nëse arsimi është më i ulët se 4 klasë, kalohet në Nënkatëgorinë B të Sesionit II

1. Sa klasë shkollë keni? _____

2. Rezultatet tuaja në shkollë kanë qenë:

- a) Shkëlqyeshëm
- b) Shumë të mira
- c) Të mira
- d) Mesatare
- e) Dobët
- f) Shumë dobët

3. Cilat lëndë ju kanë pëlqyer?

- a) Matematika
- b) Leximi

4. A keni lexuar libra jashtë shkolle?

- a) Po
- b) Jo

5. A e keni vazhduar shkollën pas lindjes së fëmijës?

- a) Po
- b) Jo

6. A punoni pas lindjes së fëmijës?

- a) Po
- b) Jo

7. A keni qëllime për karrierë profesionale?

- a) Po
- b) Jo

Nëse përgjigja është a, kaloni në pyetjen 8. Nëse përgjigja është b, kaloni në pyetjen 9

8. Në cilën fushë e shihni veten? _____

9. Ku e shihni veten pas lindjes, përveçse të qenit nënë:

- a) Arsim i mesëm / i lartë
- b) Shkollë profesionale
- c) Zanat tjetër
- d) Tregti apo biznes familjar
- e) Bujqësi
- f) Tjetër (specifiko) _____

NËNKATEGORIA B E SESIONIT II - INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PRINDËRIT

- 1. Mosha e prindërve:** _____
- 2. Gjendja ligjore e prindërve:** _____
- 3. Niveli i arsimimit të prindërve:** _____
- 4. A janë të punësuar prindërit tuaj:**
 - a) Po
 - b) Jo
- 5. Kanë qenë në emigrim prindërit tuaj?**
 - a) Po
 - b) Jo
- 6. Nëse po, cili është vendi në të cilin kanë emigruar?** _____

NËNKATEGORIA C E SESIONIT II- INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI FËMIJËN/ ËT

1. Kush ju ndihmon në rritjen e fëmijës/ ëve?

- a) Familja
- b) Të afërmit
- c) Këshillimorët
- d) Mjekët
- e) Të tjerë (specifikoni) _____

2. A është i regjistruar fëmija/ ët?

- a) Po
- b) Jo

Nëse përgjigja është a, kaloni në pyetjen 3. Nëse përgjigja është b, kaloni në pyetjen 4

3. Fëmija është i regjistruar me ju si prind?

- a) Po
- b) Jo

4. Si është gjendja shëndetësore e fëmijës/ëve?

- a) Shumë e mirë
- b) E mirë
- c) Keq
- d) Shumë keq

5. Sa fëmijë të tjerë keni lindur pas fëmijës së parë? _____

6. Nëse keni lindur vajzë, a ka pasur probleme?

- a) Po
- b) Jo

7. A jeni detyruar të kryeni abort (dështim) të fëmijës?

- a) Po
- b) Jo

8. Nëse fëmija që ju keni lindur ka qenë djalë, a ka ndryshuar statusi juaj në familje?

- a) Po
- b) Jo

NËNKATEGORIA D E SESIONIT II- INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI MARTESËN NËN MOSHË

1. Cila është arsyeja që ju jeni martuar në një moshë të hershme?

- a) Detyrim nga familja
- b) Dashuri
- c) Mënyrë për të shpëtuar nga kontrolli familjar në shtëpinë tuaj
- d) Shtatëzania
- e) Dhuna familjare në familje
- f) Gjendja e vështirë ekonomike
- g) Migrimi
- h) Zakon/ mentalitet në zonën ku jetoj

2. Cila është arsyeja që Gjykata ka legjitimuar martesën tuaj? _____

SESIONI III: SHËNIME PËR INTERVISTUESIN

1. I intervistuari a ka treguar shenja të shqetësimit emocional?

2. A është dëmtuar fizikisht ose sulmuar?

3. A ishte i/ e shoqëruar me anëtarët e familjes ose të komunitetit, kur ka njoftuar për martesë?

4. Kur i dhënë njoftimi për martesë, me kë ka folur?

5. Nëse është e komunitetit Rom a është kërcënuar në gjuhën e saj?

6. Në qoftë se është martuar me një të huaj, si ka komunikuar?

7. A ka patur informacion në lidhje me bashkëshortin e ardhshëm, duke përfshirë datën e lindjes, profesionin dhe adresën?

8. A janë bërë akuza nga palët e treta për një martesë të detyruar?